

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

A.nr.822/2017; A.nr.864/2018; A.nr.571/2019 dhe A.nr.518/2020

kundër

Doganës së Kosovës

lidhur me

diskriminimin në zbatimin e së drejtës së liritimit nga detyrimet e importit për automjet të pasagjerëve ndaj personave me paraplegji dhe tetraplegji si dhe personave të verbër

Për: Z. Ibrahim Xhaka, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm

Dogana e Kosovës

Z. Agim Krasniqi, ministër në detyrë

Ministria e Financave

Prishtinë, më 19 mars 2021

I. QËLLIMI I RAPORTIT

1. Avokati i Popullit, përmes këtij raporti, kërkon t'ia tërheqë vëmendjen Doganës së Kosovës për nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi si dhe trajtimin e barabartë të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara në kuptim të gëzimit të të drejtave dhe të përfitimeve të tyre sipas ligjeve në fuqi, por edhe për nga aspekti i veçantë i mbrojtjes kundër diskriminimit në rastet kur një situatë faktike mbulohet nga dy ose më shumë akte normative.
2. Ky raport bazohet në ankesa individuale dhe mbështetet në faktet dhe në provat e mbledhura nga ankuesi, si dhe në faktet e mbledhura gjatë hetimit nga pala përgjegjëse në lidhje me çështjen e shqyrtuar.

II. KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Gjithashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1, përcakton se Avokati i Popullit, mes tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre”* (pika 1);
- *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla”* (pika 2);
- *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave”* (pika 4);
- *“të rekomandoj qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminim”* (pika 5);
- *“t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta”* (pika 6);
- *“të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës”* (pika 8).

III. RRETHANAT E RASTIT

Faktet, provat dhe informacionet që i ka në dispozicion IAP-ja mund të paraqiten si më poshtë:

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i ka pranuar katër ankesa individuale kundër Doganës së Kosovës:

- a) A.nr.822/2017 e parashtruar nga z. Adem Ramaj, i cili për shkak të lëndimeve trupore nuk është në gjendje ta drejtojë automjetin vetë dhe ankohet kundër Doganës së Kosovës, sepse nuk ia mundësoi atij që si person me tetraplegji, në bazë të lehtësimeve të dhëna me ligj, të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, të importojë për nevojat e tij një veturë, e cila është e pajisur me urë për futjen në veturë të personit në karrocë për invalidë.
- b) A.nr. 864/2018 është parashtruar nga z. Bekim Makolli, në emër të djalit të tij, z.Milot Makolli, kundër Doganës së Kosovës, për diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuar, ku statusi dhe të drejtat e tyre rregullohen me Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, për shkak të refuzimit të jetësimit të lehtësimeve ligjore për lirim nga detyrimet e importit për automjetet e dedikuara për nevojat e këtyre përdoruesve.
- c) A.nr.571/2019 nga z. Gazmend Mehmeti, i cili ankohet kundër Doganës së Kosovës në lidhje me kërkesën e tij për përjashtim nga pagesa e detyrimeve të importit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, përkatësisht për paraplegjikët dhe tetraplegjikët dhe për personat e verbër, sepse Dogana e Kosovës, me Aktvendimin nr.321/8646, i datës 11 korrik 2019, e refuzoi kërkesën e tij për përjashtim nga detyrimet e importit për një automjet pasagjerësh për nevojat e vajzës së tij katër vjeçe, KENZA Mehmeti, e cila është person me aftësi të kufizuar, ku statusi dhe të drejtat e saj rregullohen me ligjin për statusin dhe të drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji, ndërsa kujdestari ligjor i saj është ankuesi.
- d) A.nr.518/2020 është parashtruar nga z. Avni Sylejmani, i cili është prind i një vajze të mitur me aftësi të kufizuar, kundër Doganës së Kosovës për diskriminim në lidhje me mosnjohjen e lehtësimit ligjor ndaj personave me aftësi të kufizuar, ku statusi dhe të drejtat e tyre rregullohen me Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji.

5. Më 25 janar 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ishte takuar me udhëheqësin e Zyrës për Çështje Operative në Doganën e Kosovës, të cilit ia kishte paraqitur problemin e personave me paraplegji, tetraplegji si dhe të personave të verbër, në lidhje me mosnjohjen e përfitimeve të parapara me ligj nga ana e Doganës së Kosovës për lirim nga taksat dhe detyrimet me rastin e importimit të veturave që do të përdreshin për nevojat e tyre, e paraparë me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, neni 10.1 i këtij ligji, dhe të Ligjit nr. 04/L- 092 për Personat e Verbër, si dhe neni 6. Pala përgjegjëse ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar përkitazi me këtë çështje.

6. Më 5 shkurt 2018, udhëheqësi i Zyrës për Çështje Operative në Doganën e Kosovës, përmes postës elektronike e kishte informuar përfaqësuesen e Avokatit të Popullit se çështja për të cilën po interesohej Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), që ishte prezantuar në takimin paraprak, i ishte dërguar Zyrës Ligjore në Doganën e Kosovës, e cila, pas analizës ligjore, do ta informonte IAP-në.

7. Më 21 shkurt 2018, Dogana e Kosovës, përmes postës elektronike ia kishte dërguar IAP-së Përgjigjen me nr. 01-3-2-1/202/2018 lidhur me bazën ligjore për lirim nga detyrimet e importit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, interpretimin e tyre të dispozitave

përkatëse të legjislacionit dhe praktikën e deritanishme në zbatimin e së drejtës së lirimit nga detyrimet e importit për automjetet e udhëtarëve për personat me nevoja të veçanta. Në pjesën e përgjigjes thuhej:

“[...]

Baza ligjore: Lirimi nga pagesa e detyrimeve importuese për kategorinë e personave me nevoja të veçanta/hendikepuar dhe personat e verbër që kanë të drejtë në lirim është paraparë me dispozitat e nenit 182, lidhur me nenin 76/81, të Aneksit A të Kodit doganor dhe akcizave në Kosovë, nr. 03/L-109; nenin 10 të Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik nr. 05/L-067, nenin 6 të Ligjit për persona të verbër nr. 04/L-092; pika 1.12 e nenit 30 të Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar.

Përmbledhje: Me interpretimin e dispozitave të Kodit doganor dhe Akcizave por edhe praktikës në zbatim ndër vite, të drejtë lirimi nga pagesa e detyrimeve të importit kanë personat e hendikepuar për automjetet e përshtatura në raport me të metat fizike të manifestuara (që nënkupton se automjeti me rastin e paraqitjes për vijim të procedurave doganore duhet të jetë i përshtatur llojit të dëmtimit të ekstremiteve apo të metave fizike). Pra kjo e drejtë konsiderohet të jetë e karakterit personal, sepse automjetin mund ta importoj personi i hendikepuar duke e përshtatur atë teknikisht për nevoja të veta, pa përjashtuar me këtë rast kërkesat ligjore ndërlidhur me paragrafin 2, pika b) nën ndraja e tretë e nenit 78 të Aneksit A të KDA-së, sipas të cilit parashihet (posedimi i patentë shoferit). Përmes paragrafit 1 pika a) të nenit 78 gjithashtu është paraparë se personi i tillë duhet të ketë të vërtetuar oktrina si person i hendikepuar përmes institucionit të autorizuar, (çka nënkupton se personi i hendikepuar duhet të posedoj dëshmi përkatëse nga institucioni i autorizuar mbi invaliditetin e pranuar, sepse këtë të drejtë e gëzojnë jo të gjithë personat e hendikepuar, por vetëm ata të cilët i kanë të dëmtuara ekstremitetet në atë shkallë që nuk pengon drejtimin e automjetit).

Me nën/ndarjen e pikës b) të paragrafit 2 të nenit 78 të Aneksit A të KDA-së, është përcaktuar ndalesa e huazimit, dhënies me qira, në shfrytëzim apo tjetërsimin e automjetit të liruar nga detyrimet importuese, ndërsa me nenin 79 të Ankesit A është paraparë obligimi i pagesës së detyrimeve doganore nëse automjeti huazohet, jepet në shfrytëzim apo tjetërsohet nga titullari i privilegjit doganor.

Mbi bazën e asaj që u cek më lart, me keqardhje konsiderojmë se, legjislacioni doganor në fuqi nuk ka ofruar bazë juridike e cila do të konsiderohej si e mjaftueshme përmes së cilës personat e hendikepuar në rastin konkret (të gjithë invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik dhe personat e verbër) do të mundë të përfitonin lirim nga detyrimet importuese të automjetit të udhëtarëve për nevoja të tyre. Rregullativa juridike si më lartë, përkatësisht nenet 76-81 të Aneksit A të kodit Doganor dhe Akcizave Nr. 03/L-109, me përjashtim të automjetit kanë paraparë lirime për mallra të tjera të ndërlidhura me kategorinë e personave të hendikepuar si psh, pajisje ortopedike, karroca, aparate ortopedike etj. Si dhe për personat e verbër, në Aneksin IV të Aneksit A, në mënyrë taksative janë radhitur mallrat si: letra braille, shkopi i bardhë për të verbërit, makina shkrimi për të verbërit, pajisje ortopedike dhe një numër i madh i produkteve të tjera.

Lidhur me pyetjen e parashtruar sa i përket lirimit të automjetit ndërlidhur me „Ligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik“ nr. 05/L-067 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 16.6.2016, i cili përmes nenit 10 e ka paraparë se për

përfituesit e këtij ligji me qëllim lirim nga tatimi, taksat, doganimit me rastin e importit, vlejné dispozitat e legjislacionit në fuqi, me këtë rast ju sqarojmë se në kuptim të Kodit Doganor, si legjislacion doganor në fuqi (të cilit i referohet paragrafi 1 i nenit 10 i Ligjit nr.nr. 05/L-067) privilegji i liritit vazhdon tu njihet vetëm personave të cilët paraprakisht janë të pajisur me patentë shofer dhe me kushtin që automjeti të jetë i dizajnuar apo i përshtatur për përdorim për personin e hendikepuar.

Lidhur me çështjen tjetër të paraqitur për lirim, për sa i përket automjeteve, në lidhje me “Ligjin për Personat e Verbër” nr. 04/L-092, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 14.6.2012, i cili hyri në fuqi më 01.01.2013, dekretuar HL-032-2012, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me nr. 20, të datës 18.07.2012, ligj, i cili në nenin e tij numër 6 e parashikonte lirimin e personave të verbër nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me këtë rast më lejoni t’ju shpjegoj që në aspektet oktrinarë, ligjore dhe praktike, ekziston një ndryshim i rëndësishëm në lidhje me termin “**taksë ose tatim i drejtpërdrejtë**” dhe nocionin “**taksë ose tatim i tërthortë**” në mënyrë që të arrihet deri te një përfundim i saktë, a lejohet apo jo sipas këtij rregulli lirimi i automjeteve nga detyrimet doganore.

Taksa ose tatimi direkt – (i drejtpërdrejtë), përfshin taksat dhe tatimet e llogaritura mbi të ardhurat, fitimin, pasurinë e paluajtshme dhe shërbimet publike të personave të caktuar fizik dhe juridik, të cilat duhet të transferohen në buxhetin e shtetit, p.sh. tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi fitimin, tatimi në pronë, etj., ndërsa

Taksë ose tatim indirekt (i tërthortë) – quhen taksat e përfshira në çmimin e produkteve, mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, kurse konsumatorët i paguajnë ato brenda çmimeve të produkteve dhe derdhen në buxhetin e shtetit nga personat që janë shitës të produkteve, mallrave dhe shërbimeve. Taksat dhe tatimet indirekte përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), detyrimet doganore, akcizat, etj.

Pra, siç mund të shihet nga ky shpjegim i dhënë në lidhje me termin “**lirim nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë**”, i cili është i definuar me Ligjin nr. 04/L-092, mund të konkludojmë që lirimi që kërkohet në rastin konkret (TVSH, detyrimi doganor, akciza) nuk bie brenda fushës së tatimit, siç është e definuar në nenin 6 të ligjit të lartpërmendur dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore për lirimin e automjeteve nga detyrimet doganore.

Përfundim: Përkundër respektit ndaj të gjitha kategorive të personave me nevoja të veçanta, veçanërisht kategorisë, të cilës i përket personi, i cili e ngriti këtë çështje për shqyrtim në Institucionin e Avokatit të Popullit, siç mund ta shihni nga legjislacioni ekzistues në fuqi (qoftë Kodi Doganor dhe i Akcizave qoftë Ligji për Statusin dhe të Drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji dhe Ligji për personat e verbër) fatkeqësisht, asnjëri nga këto akte nuk e ka paraparë lirimin e automjeteve nga taksat doganore për personat e kategorisë përkatëse, të cilët për arsye objektive nuk kanë automjet të përshtatur për hendikepin e tyre dhe nuk kanë patentë shofer.

Do të ishte me interes që çështja në fjalë (e drejta e liritit të automjeteve nga detyrimet doganore) për kategorinë e “**personave të verbër, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë**” të përfshihet në legjislacion sa më shpejt të jetë e mundur duke ndryshuar legjislacionin ekzistues, e drejtë kjo e cila bazuar në praktikën e mirë mund të ushtrohet në mënyrë të

tërthortë përmes kujdestarit personal, i cili është i pajisur me patentë shofer, në mënyrë që të sigurohen kujdesi ditor dhe shërbimet e nevojshme për këto kategori.

Në programin legjislativ për vitin 2018, të miratuar më 20 dhjetor 2017, në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është parashikuar një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave. Gjatë rishikimit të dispozitave të KDA, ekipi përgjegjës për hartimin e draftit origjinal ka planifikuar, ndër të tjera, ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave, që kanë të bëjnë me privilegjet doganore për personat e të gjitha kategorive me nevoja të veçanta.”

IV. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në vazhdim: Kushtetuta), neni 3 [Barazia para Ligjit] [...] shkruan: “2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]:

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. [...]”

Neni 24 [Barazia para Ligjit]:

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. [...]”

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

9. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm “KEDNj”) (4 nëntor 1950) dhe Protokollin 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm: Konventa) është një dokument ligjor që zbatohet drejtpërdrejt në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Neni 14 i Konventës thekson:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose

çdo mendim, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

Neni 1, Protokolli 12, i Konventës thekson: *Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit*

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

10. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 2, përcakton: **“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar”** ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.”

11. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi (në vazhdim: LMD)

Neni 1:

“1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, [...], aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

Neni 2:

“1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: [...],1.16. çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.”

Neni 3:

“1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze tëpërcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”

Neni 4 (Llojet e trajtimit të pabarabartë):

“1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë

të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji;

Neni 8:

“Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit.”

Neni 9:

“1. Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.

2. Avokati i Popullit ka këto kompetenca:

2.3. Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veprojnë mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik;

2.6. përcjell zbatimin e këtij ligji dhe inicon ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi.”

12. Ligji nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë (në vazhdim: LSDPT):

Neni 3: [...]

“1.1. Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

1.2. Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët) – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.”

Neni 4:

“Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.”

Neni 8 (Kujdestari personal):

“1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji.”

Neni 10 (Lirimi nga taksat dhe tatimi):

“1. Për Lirim nga tatimi, taksat, doganimi për importim dhe nga taksat për regjistrim të automjetit për nevojat e përfituesve të këtij ligji vlejné dispozitat sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përfituesit e këtij ligji lirohen nga taksat për regjistrim të automjetit personal apo të kujdestarit. [...].”

13. Ligji nr. 04/L – 092 për Personat e Verbër (në vazhdim: LPV):

Neni 3 (Përkufizimet):

“1.1. I/E verbër - personi me humbje të plotë të pamurit të lindur ose të fituar të përcaktuar sipas kriterëve mjekësore të vlerësuar nga Komisioni Mediko-social; [...].”

Neni 4:

“1. Personat e verbër mbrohen nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. [...].”

Neni 6:

“Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë. Në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi.”

Neni 7 (Të ardhurat dhe beneficionet):

“1. Personat e verbër gëzojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet sipas ligjeve në fuqi.

6. Personat e verbër nënshkruajnë kontratë me shoqëruesit e tyre, para organit kompetent të qendrës për punë sociale dhe ia paraqesin nëpunësit të organit kompetent.”

14. Kodi nr. 03/l-109 doganor dhe i akcizave në Kosovë (në vazhdim: KDA):

Lirimet nga detyrimet doganore:

Neni 182:

“Rastet në të cilat dhe kushtet nën të cilat, në rrethana të veçanta, lejohet lirimi nga detyrimet e importit apo detyrimet e eksportit, kur mallrat janë liruar për qarkullim të lirë apo janë eksportuar, janë të përcaktuara me Aneksin A dhe D në shtojcën e këtij Kodi.”

ANEKSI A

Kapitulli i (Lirimet nga detyrimet e importit)

1. Artikujt për përdorim nga personat e verbër

Neni 74:

“Artikujt e dizajnuar enkas për avancimin Arsimor, Shkencor apo Kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në Shtojcën III, lirohen nga detyrimet e importit.”

Neni 75:

“Artikujt e dizajnuar enkas për avancimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në Aneksin IV, do të lirohen nga detyrimet e importit, me kusht që ato importohen qoftë nga: - Vetë personat e verbër për nevojat e veta ose [...].”

Neni 76:

“1. Artikujt e dizajnuar enkas për avancimin arsimor, punësimin apo për avancim shoqëror të personave me paafësi fizike apo mentale, pa përfshirë personat e verbër, do të lirohen nga detyrimet e importit me kusht që janë importuar qoftë nga:

- Vetë personat e hendikepuar për nevojat e tyre personale, [...].”

Neni 78:

“1. Dhënia e lirimit të drejtpërdrejtë nga dogana për personat e verbër apo për persona të tjerë të hendikepuar, për shfrytëzim e tyre personal, siç është paraparë në paragrafin e parë të Nenit 75 dhe në paragrafin e parë të Nenit 76 (1), do t’i nënshtrohet kushti që:

1. a) [...] personat në fjalë që të rregullojnë statusin e tyre si person i verbër apo person i hendikepuar të cilët kanë të drejtë në lirim të tillë nga dogana;

1. b) mallrat e deklaruar me lirim nga dogana, janë të përshtatura në mënyrë të veçantë për nevojat e personave në fjalë.

2. Automjetet apo mënyrat tjera të transportit posaçërisht të dizajnuara apo të përshtatura për përdorim për personat të hendikepuar, të cilat janë pranuar me lirim nga taksat e importit [...]

b) që dokumenti i regjistrimit të automjetit mbanë shënimet si në vijim:

- Automjet për invalid;

- Nuk mund të huazohen, të jepen me qira apo të transferohen të personat e tjerë;

- **Shfrytëzuesi i autorizuar i automjetit:**... (emri, mbiemri dhe numri i patentë shoferit).”

Neni 79:

“1. Artikujt e importuar pa detyrime importi nga një person i përmendur në nenin 75 dhe 76 nuk mund të huazohen, jepen në shfrytëzim apo të transferohen, qoftë me pagesë apo pa pagesë, pa i njoftuar paraprakisht autoritetet doganore.

2. Nëse një artikull huazohet, jepet në përdorim apo transferohet tek një person, institucion apo organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga lirimi në pajtim me nenet 75 dhe 76, atëherë lirimi do të vazhdojë të jepet me kusht që ai person, institucion apo organizatë e shfrytëzon artikullin për ato qëllime për të cilat ajo fiton të drejtën për lirim të tillë. [...].”

V. ANALIZA LIGJORE

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës edhe realizimi i tyre praktik. Kushtetuta u siguron të gjithëve garanci për mbrojtje të barabartë para të gjitha organeve shtetërore dhe bartësve të autoritetit publik dhe krijon detyrim për shtetin për t’i mbrojtur këto të drejta në mënyrë të barabartë për të gjithë, pa ndonjë vonesë të pajustificuar, duke ndërmarrë dhe siguruar masa efektive ligjore në rast të shkeljes së ndonjë të drejte të garantuar.

16. Ndalimi kushtetues i diskriminimit shtjellohet më tej me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili parimin e barazisë e definon në nenin 3, duke rregulluar që të gjithë të jenë të barabartë dhe të gëzojnë status të barabartë dhe mbrojtje të barabartë ligjore, pavarësisht nga karakteristikat personale dhe se secili është i detyruar ta respektojë parimin e barazisë, përkatësisht ndalimin e diskriminimit. Në përputhje me këtë, personat me aftësi të kufizuara, së bashku me të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës, kanë të drejtë për mbrojtjen e të drejtave të tyre njerëzore dhe barazinë para ligjit, pa dallim në kuptimin e origjinës, seriozitetit dhe natyrës së aftësisë së kufizuar.

17. Po ashtu në të drejtën ndërkombëtare, diskriminimi paraqet çdo dallim, refuzim ose kufizim mbi çdo bazë të mbrojtur ligjërisht, përfshirë edhe në bazë të aftësisë së kufizuar, qëllimi ose efekti i të cilit është shkelja ose anulimi i pranimit, gëzimit ose ushtrimit në mënyrë të barabartë me të tjerët i të gjitha të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile dhe në fusha të tjera.

18. E drejta ndërkombëtare e thotë qartë se nuk guxon të ekzistojë shkallë e të drejtave dhe e dinjitetit të njeriut, por barazi për të gjithë. Në përputhje me këtë: “Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim”¹; mbi çfarëdo baze, në mënyrë të tillë që autoritetet publike të mos e diskriminojnë askënd në kuptimin e kufizimit të gëzimit të të drejtave të dhëna me ligj.

19. Në kontekstin e kësaj, duke pasur parasysh që LPV-ja kishte hyrë në fuqi më 1 janar 2013, kurse LSDPPT-ja kishte hyrë në fuqi më 1 janar 2017, është i qartë detyrimi i të gjitha organeve shtetërore që t’i respektojnë dhe t’i zbatojnë dispozitat e tyre, duke mos i përjashtuar dhe kufizuar në kuptimin e gëzimit të të drejtave të përfituesve.

20. Sipas legjislacionit përkatës, statusi juridik i personave me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe i personave të verbër, rregullohet nga ligjet e veçanta, LSDPPT-ja dhe LPV-ja, përfituesit e të cilëve, midis tjerash, janë përfitues të lehtësirave të caktuara, siç janë: lirimi nga detyrimet e importit për artikujt e dedikuar për përdorimin e tyre ose të dedikuar për ta. Kushtet dhe mënyra e lirimit nga pagesa e detyrimeve të importit për personat me nevoja të veçanta, po ashtu me dispozitat e veta, i parashek dhe i rregullon ligji i përgjithshëm KDA², i cili kishte hyri në fuqi në 10 nëntor 2008.

21. Avokati i Popullit vëren se në përputhje me rregullat relevante ligjore të çështjes, e cila është duke u trajtuar, ekzistojnë dy situata në të cilat, në varësi të llojit dhe shkallës së dëmtimit ose paaftësisë fizike, mund të gjenden njerëz me aftësi të kufizuar të cilëve u takon e drejta për të cilën flitet këtu, pra që:

- ta importojnë personalisht një automjet motorik për nevojat e tyre, me një mekanizëm drejtues të përshtatur posaçërisht për nevojat e tyre, i cili ia mundëson përdoruesit që me pajisjen me patentë shoferi ta drejtojë atë;
- ta importojë një automjet motorik, qoftë personalisht ose indirekt përmes kujdestarit, i cili është përshtatur në mënyrë të veçantë dhe është i dedikuar për nevojat dhe transportin e përdoruesve, të cilëve shkalla e dëmtimit trupor nuk ua ofron mundësinë për ta drejtuar atë personalisht.

22. Për lehtësirat në fjalë, është e qartë se neni 10 i LSDPPT-së i liron përfituesit e këtij ligji “nga taksat për regjistrim të automjetit personal apo të kujdestarit”. Gjithashtu, neni 6 i LPV-së i liron personat e verbër “nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë.” Ndërsa KDA-ja në nenin 182 siguron përfitime nga lirimi nga taksat doganore, kurse rastet dhe kushtet nën të cilat jepen përfitimet edhe më saktësisht rregullohen në nenet 76-78 të Shtojcës A të këtij Kodi.

23. Dispozitat përkatëse të KDA-së e bëjnë të qartë se “artikujt e dizajnuar enkas për avancimin arsimor, punësimin apo për **avancim shoqëror**” (në artikujt e avancimit shoqëror përfshihet edhe automjeti motorik), lirohen nga detyrimet e importit nëse i importojnë

¹ Neni 1, Protokollin 12, i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

² Neni 182, lidhur me nenin 76-81, Aneks A, KDA.

“personat me paaftësi fizike apo mentale, pa përfshirë personat e verbër”, “për nevojat e tyre personale...”

Avokati i Popullit vëren se paaftësia fizike ose mendore përgjithësisht paraqet një mangësi që e kufizon një person të kryejë një ose më shumë aktivitete jetësore. Në dëmtimet fizike përfshihet edhe: shikimi i dëmtuar, dëgjimi i dëmtuar, komunikimi i dëmtuar përmes të folurit-zërimit, sistemi lokomotor i dëmtuar, sistemi nervor qendror i dëmtuar, sistemi nervor periferik dhe muskulator i dëmtuar, si dhe dëmtimi i organeve të tjera dhe i sistemeve të organeve. Prandaj, në grupin e personave me aftësi të kufizuara fizike sigurisht bëjnë pjesë edhe përfituesit e LPV-së dhe LSDPPT-së, shkalla e aftësisë së kufizuar e të cilëve i kufizon shumë aktivitete dhe aftësi jetësore, si rezultat i së cilës përfituesve u njihet e drejta të kenë një përcjellës, përkatësisht kujdestar personal, me qëllim që t’u ofrohet kujdesi dhe shërbimet e domosdoshme ditore. Po ashtu, personat me të meta mendore janë persona me zhvillim të pamjaftueshëm mendor ose me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët nuk e kanë kapacitetin e plotë për gjykim dhe sjellje të shëndoshë dhe mund të jenë pjesërisht ose plotësisht të privuar nga aftësia juridike, në situata në të cilat interesat e tyre dhe të drejtat e përfitimit sigurohen dhe mbrohen në mënyrë të tërthortë përmes kujdestarit ligjor.

24. Në kuptimin e asaj që u tha më lart, është fakt se KDA-ja me persona me aftësi të kufizuara nënkupton personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, të cilët, për shkak të natyrës së aftësisë së tyre të kufizuar, nuk kanë dhe nuk i kanë të njëjtat shkathtësi dhe aftësi, prandaj edhe vetë ligjvënësi nuk mund t’i presë dhe t’i kërkojë ato. Prandaj, KDA-ja e jep dispozitën e përbashkët në nenin 78 të Aneksit A, për të cilën do të bëhet fjalë në vazhdim.

25. Dispozita e KDA-së (neni 78, paragrafi 1) thotë: “*Dhënia e lirim të drejtpërdrejtë nga dogana për personat e verbër apo për persona të tjerë të hendikepuar, [...]*.” Është e qartë se kjo dispozitë e ligjit në asnjë mënyrë nuk kufizon ose nuk udhëzon në atë që: “*Këtë të drejtë e gëzojnë jo të gjithë personat e hendikepuar, por vetëm ata të cilët kanë të dëmtuara ekstremitetet në atë shkallë që nuk pengon drejtimin e automjetit*”, siç e interpreton Dogana e Kosovës, por pa mëdyshje i përfshin të gjithë përfituesit e së drejtës së dhënë me ligj të cilët “*rregullojnë statusin e tyre si person i verbër apo person i hendikepuar të cilët kanë të drejtë në lirim të tillë nga dogana*”³; për nevojat ose qëllimin e të cilit importohet automjeti.

Avokati i Popullit në këtë kontekst thekson se nuk është kontestuese që një person me aftësi të kufizuara mund të regjistrohet si pronar i automjetit. Gjithashtu, regjistrimi i pronësisë dhe regjistrimi i automjeteve nuk varen dhe nuk sjellin detyrimin që pronari i automjetit duhet të ketë patentë shoferi.⁴

26. I njëjti nen, pika b, më tutje e parasheh që mallrat që janë të liruara nga detyrimet doganore i nënshtrohen kushtit që të jenë “*të përshtatura në mënyrë të veçantë për nevojat e personave në fjalë*” dhe që të jenë “*posaçërisht të dizajnuara apo të përshtatura për përdorim për personat të hendikepuar*” dhe që “*automjetet apo mënyrat tjera të transportit posaçërisht të dizajnuara apo të përshtatura për përdorim për personat të hendikepuar, të cilat janë pranuar me lirim nga taksat e importit [...]*”⁵ Avokati i Popullit konsideron se kjo dispozitë ligjore nuk e specifikon një lloj të veçantë përshtatjeje vetëm për një kategori të caktuar të personave me nevoja të veçanta, por i referohet çdo përshtatjeje speciale për

³ KDA, Aneks A, neni 78, paragrafi 1, pika a.

⁴ Ligji nr. 05/L-132 për Automjete.

⁵ KDA, neni 78, paragrafi 2.

nevojat e përfituesve ligjor, në përputhje me kategorinë, natyrën dhe shkallën e invaliditetit të tyre.

Në përputhje me këtë, “mënyra e veçantë e përshtatjes” së automjeteve për personat me nevoja të veçanta mund të nënkuptojë si në vijim: Mekanizmi drejtues, i përshtatur për llojin e aftësisë së kufizuar fizike, për përdoruesit që kanë aftësinë që me patentë shoferi ta drejtojnë automjetin në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, për përdoruesit (paraplegjikët, tetraplegjikët dhe personat e verbër), të cilët për shkak të natyrës, llojit dhe shkallës së dëmtimit të tyre ose paaftësisë fizike, nuk kanë dhe nuk mund të kenë aftësi që, pavarësisht përshtatjes, të drejtojnë automjet në mënyrë të pavarur, që nënkupton një lloj tjetër të përshtatjes speciale, në një mënyrë të tillë që një person të mundë të futet në të me një karrocë ose çfarëdo mjeti tjetër ortopedik (p.sh. një karrige, shtrat ose shtrat i dizajnuar posaçërisht), përmes një rampe ose ashensori, në të cilin është instaluar një mekanizëm për përforsimin e tyre me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë për transportin e tyre.

Prandaj, rregullativa e veçantë ligjore, për shkak të natyrës së aftësive të kufizuara fizike, ua njeh të drejtën e personave të verbër, si dhe personave me paraplegji dhe tetraplegji që të kenë një përcjellës ose kujdestar personal,⁶ me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore.

27. Duke u bazuar në atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit konsideron se konstatimi i Doganës, së Kosovës i dhënë në arsyetim se derisa përfituesi i lehtësirave nuk mund ta drejtojë automjetin, ai nuk mund ta plotësojë qëllimin për të cilin është dhënë lehtësira, është në kundërshtim me dispozitat qoftë të ligjeve të veçanta, si LPV dhe LSDPPT, qoftë me dispozitat e ligjit të ashpër KDA. Një praktikë e tillë e Doganës së Kosovës është gjithashtu në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kundër diskriminimit, sepse ua kufizon përfituesve të drejtën në kuptimin e shkallës dhe të kategorisë së aftësisë së tyre të invaliditetit. Ky qëndrim i Avokatit të Popullit, në situatën krahasuese, është në përputhje me praktikën gjyqësore, me qëndrimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë⁷ dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës.⁸

28. Avokati i Popullit gjithashtu vë në dukje këtu një bazë tjetër të kufizimit të personave me nevoja të veçanta si përfitues të ndihmës në fjalë dhe kjo është që Dogana e Kosovës, me

⁶ Ligji nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji, neni 8.

⁷ Gjykata Themelore në Prishtinë. Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal. Aktgjykimi A.nr.1125/2015, i datës 26.6.2018. Në konfliktin administrativ kundër vendimit të Doganës së Kosovës dhe të moslirimit nga detyrimet doganore për importim të automjetit për nevoja të N. S., person me nevoja të veçanta, si përfitues i lehtësirave të dhëna në LPV, në pjesën e duhur thuhet: „Sipas interpretimit tonë gjegjësisht mbi bazën e nenit 78 të shtojcës (a) dhe (b) zotëri N.S. i lejohet importimi i veturës pa asnjë taksë nga se edhe mbi bazën e kësaj dispozite i lartcekuri ka të drejtë të ketë personin e autorizuar për ngasjen e automjetit. Dogana e Kosovës ka kërkuar nga i njëjti që të ketë patentë-shoferin, në mënyrë që të lirohet nga taksa doganore. Mbi bazën e dijenisë tonë personi i verbër i shkallës së parë nuk mund të posedon patentë-shofer, sepse ai nuk mund ta dallon edhe dritën nga errësira e lëre më të ngasë veturën. Argumentet tona janë të mbështetura mbi bazën juridike si: Ligji nr.04/L- 092 për personat e verbër [...]“, i cili ka filluar së zbatuari nga 01.01.2013, në nenin 6 të këtij Ligji në paragrafin e parë të tij, personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtëpërdrejtë, rrjedh se z. S. lirohet edhe nga taksa për importimin e veturës, besojmë fuqishëm se gjykata ka tagra ligjore që të bazohet edhe në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi mbi bazën e të cilit Ligj besojmë fuqishëm se Dogana e Kosovës ka diskriminuar rëndë z.N.S. Gjykata ka targa ligjore po ashtu që të bëjë referencë incidentale edhe në Kushtetutën e Kosovës, gjegjësisht nenin 44 të saj, ku dogana e detyron z.N.S. që të sjellë një librezë të lëshuar nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, edhe pse liria e asociimit është e garantuar mbi bazën e të njëjtës dispozite kushtetuese.“

⁸ Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimi AA:br.414/2018, datë 31.1.2019: „... në rastin konkret pasi që paditësi nuk është i aftë për të vozitur, e paditura konsiderom se nuk mund të përmbushet qëllimi për të cilin është lejuar ankimi. Këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, drejtë ka konstatuar se e paditura nuk ka marrë fare parasysh pretendimet e paditësit se në bazë të dispozitës së nenit 6 të Ligjit nr. 04/L092 për personat e verbër, i njëjti lirohet nga të gjitha taksat dhe tatimet, pasi që i takon kategorisë në grupin e parë – personat e verbër, [...]“

praktikën e vet dhe kushtin e dhënë për posedimin e patentë shoferit, të drejtën për këtë çështje ua lejon vetëm personave me nevoja të veçanta mbi 18 vjeç, sepse në mënyrë analoge si më sipër, vetëm të rriturve u jepet mundësia me ligj të pajisen me patentë shoferi. Që do të thotë se Dogana e Kosovës, pa kurrfarë baze ligjore, i kufizon përfituesit të gëzojnë lehtësira doganore për importin e automjeteve, edhe në aspektin të moshës.

29. Sa i përket nënndarjes së dytë të së njëjtës dispozitë, sipas së cilës, automjetet e destinuar për personat me aftësi të kufizuara: ***“Nuk mund të huazohen, të jepen me qira apo të transferohen te personat e tjerë”***, në të cilën, në favor të interpretimit të vetë së drejtës për çështjen në fjalë thirret Dogana e Kosovës, është paraparë një ndalim dhe këtu nuk ka asnjë paqartësi, por Avokati i Popullit e thekson se ky ndalim në asnjë mënyrë nuk ndikon në kufizimin e të drejtave të përfituesve të ligjshëm për lirim nga lehtësirat e dhëna, por vetëm parasheh ndalesa të caktuara nëse automjeti huazohet, jepet me qira ose tjetërsohet nga bartësi i së drejtës së privilegjit doganor.

30. Nënndarja e tretë e nenit 78 të Aneksit A të ZCA-së, në pjesën e duhur thotë: ***“Përdoruesi i autorizuar i automjetit ... (emri dhe mbiemri dhe numri i patentë shoferit).”*** Avokati i Popullit vë në dukje se kjo dispozitë e Kodit udhëzon që përfituesit e lehtësirave të dhëna për importin e automjetit, nëse për shkak të natyrës së aftësisë së kufizuar, ata objektivisht nuk mund ta drejtojnë automjetin e vetë, kanë të drejtë ta kenë një person të autorizuar, të pajisur me patentë shoferi. Në këtë mënyrë ligji ua mundëson përfituesve të privilegjeve që në mënyrë të tërthortë ta ushtrojnë një të drejtë të caktuar, sepse legjislacioni i veçantë, për shkak të natyrës së aftësive të kufizuara fizike, personave me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe të personave të verbër ua njeh të drejtën të kenë një kujdestar personal, në mënyrë që t’u ofrohet kujdesi dhe shërbimet e nevojshme ditore.⁹

31. Gjithashtu, në lidhje me situatën e paraqitur, Avokati i Popullit thekson se në teorinë ligjore shpesh ka raste kur një situatë faktike mbulohet nga dy ose më shumë akte normative. Një situatë e tillë ngre menjëherë shqetësime në lidhje me sigurinë ligjore të përfituesve dhe ka implikime të rëndësishme në të drejtat e njeriut, si dhe në aftësinë e institucioneve për ta përbushur misionin e vet në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Avokati i Popullit, lidhur me çështjen se cilit akt normativ duhet t’i jepet përparësi në situatën faktike, e cila mbulohet me dy ose më shumë akte të tilla, ka publikuar Raport me rekomandime *Ex officio* nr. 441/2018, datë 28 shtator 2018 (i bashkëngjitur në shtojcë), i cili në një mënyrë të veçantë mund të jetë i zbatueshëm në lidhje me çështjen në shqyrtimin e këtij raporti.

32. Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, në lidhje me çështjen në shqyrtim, e cila është mbuluar me më shumë se dy akte ligjore, Avokati i Popullit konsideron se edhe në këtë rast

⁹ Qëndrimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal, Aktgjykimi A.nr.1125/2015, i datës 26.6.2018. Gjykata në pjesën e arsytimit të aktgjykimit konsideron se është i papranueshëm konstatimi i Doganës së Kosovës: *“Derisa përfituesi i lehtësirave nuk mund ta drejtojë automjetin ai nuk mund ta plotësojë qëllimin, për të cilin është dhënë lehtësira.”* Në këtë rast, Gjykata nxjerr konkluzionin se Dogana e Kosovës: *“Nuk është dashur ta që ta refuzojë kërkesën e paditësit për t’u liruar nga taksat doganore për mallin doganor, me arsyetimin se nuk mund ta drejtojë automjetin personalisht paditësi apo supozimet se malli nuk duhet huazuar apo ti jepet në shfrytëzim dikujt tjetër.”* Dogana e Kosovës *“nuk është dashur që ti shmanget zbatimit të dopsozitave ligjore në fuqi, duke dhënë mendime të ndryshme se paditësi nuk mund të drejtojë personalisht automjetin, apo se automjeti mund ti jepet në shfrytëzim palës tjetër. Nga një gjendje e tillë faktike nga e cila rezulton se e paditura.”* Dogana e Kosovës *“nuk i ka aplikuar drejt dispozitat ligjore në fuqi, nuk ka vërtetuar faktet esenciale respektivisht ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike si rezultat i së cilës është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale. [...]”*

ka vend të zbatohen tri principet: „*Lex specialis derogat legi generali*“,¹⁰ principi „*Lex posterior derogat legi priori*“¹¹ dhe „*Lex superior derogat legi inferiori*“¹², të shtjelluara më thellë dhe të prezantuara në Raportin *Ex officio* nr. 441/2018, i nxjerrë nga Avokati i Popullit.

VI. MENDIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

33. Në bazë të fakteve të paraqitura në këtë rast, është e pakontestueshme që Dogana e Kosovës ia mundëson privilegjin doganor vetëm një kategorie personash me aftësi të kufizuara nga mosha 18 vjeç, sepse në të njëjtën mënyrë i trajton kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, duke mos marrë parasysh dhe duke mos bërë dallim në bazë të shkallës dhe natyrës së mungesës së aftësisë së tyre fizike.

34. Duke vendosur një kusht të përgjithshëm - posedimin e patentë shoferit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, Dogana e Kosovës i përjashton personat me paraplegji, tetraplegji, personat e verbër, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara që ta gëzojnë të drejtën e dhënë ligjërish për privilegjet doganore në fjalë. Kushti i vënë për përfituesit e së drejtës në fjalë, për shkak të natyrës së invaliditetit të tyre, është një kusht objektivisht i pamundur, të cilin ata nuk mund ta plotësojnë në asnjë mënyrë dhe i vendosë ata në një pozitë të pabarabartë në raport me kategori tjetër të personave me aftësi të kufizuar, për të cilët, për nga natyra dhe shkalla e aftësisë së tyre të kufizuar, ky kusht është i realizueshëm.

35. Avokati i Popullit e konsideron se qëllimi i së drejtës për përfitime të caktuara që u jepen personave me aftësi të kufizuar duhet të pasqyrohet në parimin e qasjes së barabartë të të drejtave të dhëna për të gjithë, bashkë me kushtet dhe mënyrën e duhur të përdorimit të tyre, duke u nisur nga këndvështrimi i llojit dhe i shkallës së invaliditetit të tyre.

36. Prandaj si rezultat i asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit mendon se legjislacioni përkatës LPV, LSDPPT si dhe DK, në mënyrë të plotë, pa asnjë pengesë, ua njeh dhe u ofron përfituesve të së drejtës në fjalë një bazë të mjaftueshme ligjore për gëzimin e së njëjtës.

VII. KONKLuzionet e Avokatisë së Popullit

37. Mbrojtja e tërësisë së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, në lidhje me çështjen në shqyrtim, nënkupton zbatimin e plotë të së drejtës për përfitime doganore për të gjithë përfituesit e legjislacionit përkatës.

38. Praktika e Doganës së Kosovës, e cila, duke vendosur një kusht të përgjithshëm – “posedimi personal i patentë shoferit” për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, përjashton drejtpërdrejt personat me paraplegji, tetraplegji dhe personat e verbër nga gëzimi i së drejtës së dhënë ligjërish për privilegjet doganore në fjalë. Një mohim i tillë i pajustificuar, dhënie përparësi ose kufizim i të drejtave të përfituesve në bazë të shkallës dhe të kategorisë së invaliditetit të tyre **paraqet akt të diskriminimit të drejtpërdrejtë** dhe shkelje të legjislacionit që e ndalojnë diskriminimin, që janë obliguese për të gjithë personat juridikë, prandaj

¹⁰ Ex-officio nr.441/2018, principi i shqyrtuar në këtë pjesë të këtij raporti është paraqitur në pikat 6-20. (a) *Lex specialis derogat legi generali*. „Princip *lex specialis derogat legi generali* (në tekstin e mëtejshëm: “*lex specialis*”), përcakton që kur një situatë e caktuar faktike përfshin fushën e dy akteve normative, përparësia i jepet aktit të veçantë në raport me aktin e përgjithshëm.”

¹¹ Po aty, shih pjesën C të raportit.


¹² Po aty.

REKOMANDON

- *Dogana e Kosovës, pa vonesa të mëtejshme, të krijojë kushte për zbatimin e plotë të së drejtës së dhënë me ligj për lehtësimet doganore, në lidhje me importin e automjeteve të pasagjerëve, të përshtatura për nevojat e personave me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe për personat e verbër, me mundësi të ushtrimit indirekt të të drejtave të përfituesit përmes kujdestarit ligjor ose personave të autorizuar, të pajisur me patentë shoferi (neni 10 i Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, dhe neni 6 i Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.)*
- *Dogana e Kosovës, në të ardhmen, praktikën e vet ta harmonizojë me legjislacionin kundër diskriminimit, të ketë kujdes të përmbahet nga bërja e pajustificuar e dallimeve ose trajtimeve të pabarabarta (siç është: përjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësive) në raport me personat ose grupet e personave që bazohet në një karakteristikë personale me praktikat dhe vendimet e veta.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit